



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIJËS DHE ENERGJISË

Nr. 8459/prot.

Tiranë, më 20.11.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1707, datë 23.05.2014.

SHOQËRISË “BYTYÇI” SH.P.K
Vlad, Pac, Tropojë, Kukës

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “BYTYÇI” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1707, datë 23.05.2014, për mineralin krom, në objektin “Babinë, Llugaj”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 4849, datë 17.10.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 8459 Prot., datë 21.10.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1707, datë 23.05.2014, për mineralin krom, në objektin “Babinë, Llugaj”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, pasi në objektin minierar nuk ushtrohet aktivitet prej më shumë se një viti dhe subjekti nuk ka të miratuar planin vjetor të punës për vitin 2023-2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit**

për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1707, datë 23.05.2014, për mineralin krom, në objektin “Babinë, Llugaj”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1707, datë 23.05.2014, për mineralin krom, në objektin “Babinë, Llugaj”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI**

BELINDA BALLUKU

**ME URDHËR PËR DELEGIM
ZËVENDËSMINISTRI
CENO KLOSI**

